



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008) dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJE FINANCIARE VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Neni 1 Qëllimi

1. Miratohet Vendimi për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i ndihmës financiare në strehim, ushqim dhe përkrahje në përkujdesje të fëmijëve, që do t'u ofrohet rasteve të viktimave të dhunës në familje.
3. Procedurën për përkrahje financiare e inicion menaxheri i rastit në QPS Prishtinë. Në rast se viktimë është e strehuar në Strehimore për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, menaxheri i rastit nga QPS Prishtinë, në bashkëpunim me menaxherin në Strehimore përkrah dhe ndihmon viktimën në kompletimin e dokumentacionit.
4. Për rastet që janë viktimë të dhunës në familje, por që nuk janë të strehuara në strehimore, QPS përmes ekipit të saj konstaton rrethanat dhe nevojën për aplikim të përkrahjes financiare për banim social.

Neni 2

Komponentët e ndihmës

1. Ndihma që do përfitojnë rastet e viktimave të dhunës në familje është e karakterit financiar. E njëjta ka për qëllim plotësimin e nevojave për jetesë, riintegrim dhe fuqizimin për jetesë të pavarur.
2. Ndihma është e ndarë në tre komponentë të saj (dhe jo domosdoshmërisht një viktimë mund të përfitojë të tre komponentët):
 - Subvencionimi i banimit, në lartësi deri në 250 euro ne muaj;
 - Subvencionimi i mjeteve për jetesë, në shumë prej 150 euro në muaj. (Aplikohet kur viktimë nuk është përfitues nga Skema e Ndihmës Sociale);
 - Në rast se viktimë ka fëmijë në përkujdesje, kjo shumë rritet në vlerë deri në 100 euro.

Neni 3

Vlerat e përfitimit maksimal

1. Vlera maksimale e përkrahjes financiare, në rast kur aplikohen të tre komponentët të përcaktuara në nenin 2, nuk mund të tejkalojë shumën prej 500 euro në muaj.

Neni 4

Afatet e ndihmës

1. Kjo ndihmë mund të ofrohet në një afat prej 6 muajve, i cili mund të vazhdohet më së shumti deri në 2 vjet.
2. Ndihma mund të ofrohet edhe në afat më të shkurtër, por e njëjta edhe mund të ndërpritet edhe më herët sesa që është përcaktuar paraprakisht sipas vlerësimeve të Qendrës për Punë Sociale dhe Komisionit Komunal Vlerësues për viktimat e dhunës në familje.

3. QPS Prishtine, përmes ekipit profesional bën propozimin te Komisioni Komunal Vlerësues për ndërprerjen e përkrahjes financiare për shkak të ndryshimit të rrethanave si vijon:

- 3.1. Punësimi/ rikthimi në marrëdhënie pune;
- 3.2 Bashkimi familjar me bashkëshortin;
- 3.3. Ndryshimi i vendbanimit;
- 3.4 Ndryshimi i statusit martesor;
- 3.5 Të gjitha rrethanat tjera që vlerëson ekipi profesional.

Neni 5

Kriteret për përfitim nga banimi social

1. Për të qenë përfitues i banimit social, QPS Prishtinë obligohet të nxjerrë konstatim zyrtar për secilin rast, duke i respektuar kriteret e parapara si në vijim:
 - Dokumenti i cili dëshmon se rasti është i hapur në polici;
 - Dokumenti i cili dëshmon se viktimi ka paraqitur kërkesë për urdhër për mbrojtje dhe procesverbalit apo vendimit të Gjykatës përkatëse;
 - Dokumenti i identifikimit;
 - Certifikatat e fëmijëve;
 - Certifikata e bashkësisë familjare;
 - Kartela e xhirollogarisë;
 - Kontrata e noterizuar e banimit ;
 - Dëshmi apo referim nga strehimorja, nëse është e aplikueshme;
 - Konstatimi zyrtar nga QPS.

Neni 6

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe organet e tjera relevante.

Neni 7
Ilyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-450/03-257590/22, më 25.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

